

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr.
05/L-092

Një ankesë kundër: KUVENDI I KOMUNES - KAÇANIK

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 652-26-846-2-2-1

Sa i përket tenderit për Mirmbajtja e ndriqimit publik

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

PLUS TRADE LLC
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

GURSEL & BAJRAM SEYLEJMANI, FERIZAJ
(Adresa)

FERIZAJ 70000
(Vendi) (Kodi postar)

044 100 139
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Përparim Dalloshi
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Plustradellc@gmail.com
(Adresa elektronike)

28.06.2026
(Data e parashtrimit të kërkesës) (Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtrojë kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë	26.02.2026 14:40
Procesi Verbal	23.03.2026 14:20
Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues	09.06.2026 14:33
Kerkesa per rishyqritm	16.06.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 Qëllimi
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti
Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi ,
Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve si dhe
Neni 61 Tenderet jo normalisht te ulet dhe 41 të RRPP-001/2022
Neni 69 Aftësia Teknike dhe Profesionale
Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtese

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne kemi bere kerkesen per casje ne kete date 10.06.2026 ndersa casja na eshte ofruar pas 2 dy dite, per shkak te festes ne Komunen e Kacaniku ditën e enjte nuk eshte punuar dhe ditën e premte 12.06.2026 kemi komunikuar me zyren e prokurimit por qe te njejtet kane konfirmuar qe eshte ne pushim per shkak te aksidentit qe ka pasur.

Nga momenti qe kemi pranuar dokumentet nuk kane kaluar 5 dite qe te bejme analizen e tyre, andaj pa ta drejte eshte dhene vendimi i AK-se ndaj kerkeses sone.

Ne ne momentin qe kemi pranuar dokumentet e OE ekonomik kemi hasur ne keto:

Pas analizimit të këtyre dokumenteve mund të thuhet se gjatë procedurës formale të vlerësimit të tenderëve që kanë marrë pjesë në këtë aktivitet prokurimi, nxjerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat ligjore procedurale dhe materiale të LPP-së për shkak se gjatë mënyrës dhe metodës se vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve, nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë kushtet dhe kërkesat e trajtimit të barabartë të OE në procesin e vlerësimit

1. AK ka shkelur nenin 1 dhe 6 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave dhe administrimit me procedurën e prokurimit në përgjithësi, nuk ka luajtur rol aktiv për tu siguruar që fondet publike po shfrytëzohen në mënyrë efikase dhe efektive. Neni 1 shumë qartë e thotë se: Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Kjo nuk është respektuar aspak në rastin konkret sepse OE që AK e ka shpallur fitues edhe pse posedon çmimin më të ulët se ne, brenda listës së çmimeve ka ofruar çmime spekuluese që për AK do të kushtoj shumë me tepër se sa kontrata jonë.

2. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë procesit të vlerësimit të ofertave nuk i ka trajtuar të gjithë tenderuesit në mënyrë të barabartë. E themi këtë sepse edhe përkundër faktit që kete OE i shpallur fitues nuk i ka kerkuar sqarime për çmimet nominalishte te uleta dhe

cmime ne disa pozicione spekulative. OE i shpallur fitues posedon çmimin më të ulët se ne por ka mangësi në tenderin e tijë duke potencuar veçanërisht çmimet spekuluese të pa sqaruara prandaj mos vlerësimi i tenderëve në mënyrë të drejtë dhe favorizimi i OE që është shpallur fitues e bënë AK-në shkelëse të plotë të nenit 7 të LPP-së.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka aplikuar drejtë kërkesat e përcaktuara paraprakisht në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Pika 4 e këtij neni thotë se: Autoriteti Kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Ne konsiderojmë se ky nen është shkelur me rastin e vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve e posaçërisht të tenderit që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti posedon mangësi të theksuara në tenderin e tijë. Këtë e themi sepse ky OE ka ofruar çmime jo normalisht të ulëta të cilat AK nuk ka arritur të i kerkoj sqarime ashtu siç e kërkon ligji dhe rregullorja.

Përpos kësaj pas qasjes në dokumentet e tenderit nuk kemi pare dokumnetet se ky OE kishte dorëzuar vërtetimin e ATK-së dhe te gjykates.

4. AK ka shkelur nenit 61 të LPP-së si dhe ka shkelur **nenin 41.8 dhe 41.9 të RRPP001/2022** pasi që nuk e ka aplikuar drejt dhe si duhet sqarimin e çmimeve jo normalisht të ulëta tek OE që e ka shpallur fitues. Paraqesim pozicionet me cmime jo normalist të ulëta:

49	<p>Furnizimi dhe montimi i kuadrit shperndares KSHE, me dimensione 600x600x20mm, IP65, propozohet CDCP,ABB, tabela duhet te jete metalike e galvanizuar ose PVC, siq eshte pershkuar ne pershkrim teknike.Karakteristikat teknike:Enclosure series CDC and SDC are made of galvanized steel sheet and with the performance standards ISO 1461, IEC 61439-1, IEC 61439-5. Element perberse jane:</p> <p>1.Nderperes magneto termike AS-160/R63A, 3p, Icc=10kA.</p> <p>2. Njehsor matese i energjise 3f, 80A, per matje dirkete</p> <p>3. Siguresa automatike 3p, C, 20A , Icc=6kA=4set.</p> <p>4. Konkator 3p, 230V, 25A modulare =4cope.</p> <p>5. Nderperes (0,1,2), 2p, 16A=2cope.</p> <p>6. Digital time switch with an astronomical program SHT-4 =1pcs</p> <p>7. Siguresa automatike 6A,1p, C, Icc=6kA.</p> <p>8. Materiali i imet lidhes.</p> <p>9.Në llogari hynë edhe mihja dhe betonimi i themelit të kuadratit.</p>	copë	1.00	10.00	10.00 €
----	-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------	------	-------	---------

Pozicioni 49 me te gjitha keto elemete eshte paraqitur me cmim 10 euro ku kemi mbi 9 elemente qe aludohet qe cdo element kushton nga 1 euro sipas ketij OE duke mos e perfshire

edhe punen e montimit. Parqitja e tille e cmimeve eshte e papergjeshme nga ana e ketiJ oe andaj edhe oferta e tij duhet te refuzohet nga AK-ja.

Dhe pozicionet si:pozicioni 6, 7,8,9 ku kabllo e fraksioneve te ndryshme kane cmim te njejte nga 2 euro ku keto kabllo ne treg jane me cmim shume me te larte, ku gjithahstu ne pozicione jane perfshire perpos furnizimit te kabllos edhe elemete te tjera percjella se bashku me instalim gje qe ky OE ka paraqitur cmime manipulative.

Pozicionet 11 deri ne pozicionet 20 jane te gjitha produkte te cilat jane ofertuar me cmime te uleta dhe te papranueshme pasi jane produkte te cilat kushtojne shume shtrenjte ne treg.

Dhe pothuajse ne te gjitha cmimet ne paramase jane me cmime 1 euro, pra cmime te paergjshme.

E gjithe oferta e ELEKTRIKA MONT eshte manipulative dhe e papergjeshme e cila ka ofruar cmime nominalisht te uleta dhe te papranueshme. Andaj ky OE eshte i papergjeshem dhe duhet te jete i eliminuar

Poashtu edhe OE Tandem CO shpk ka preznetuar cmime manipulative nga 0.10 cent te cilat jane te papranueshme andaj edhe ky OE eshte i papërgjegjshëm gjithashtu i njejti nuk ka asnje projekt te realizuar per ndricim, te gjitha projektet qe i ka prezentuar ne listen e tij jane projekte te natyres tjeter andaj ky OE ehste i papergjeshem dhe i eliminuar

OE ETM Group shpk, te gjitha referencat e preznetuar jane pothuajse referneca private pa deshmi pagese, ku zakonsht per vertetesine e ketyre projekteve AK kerkojne edhe dehsmi pagese per shkak te mundesive te referencave dhe kontratave fiktive. Andaj, konsiderojme qe ky kriter eshte i palotesuar pasi kemi vetem nje refernec nga autoritet publik e cila nuk permbush vleren e kerkuar sipas FTD-se

Edhe ky Oe ne shumicen e pozicioneve ka ofruar cmime nominalisht te uleta duke e bere oferten te papergjshme pasi cmimet e ofruara nuk munden te gjinden ne treg me ato cmime, ku ne secilin pozicion perpos furnizimit eshte edhe pjesa e montimit andaj nuk mundet qe te realizohet nje kontrate e tille me keto cmime pasi jane nen cmim te tregut. Te gjitha pozicionet e kabllove jane nen cmim te kostos, ku siq dihet nga faktoret e shumte ekonomik, cmimet e kabllove vazhdimisht jane ne rritje, si dhe pozicione te tjera si ormani kryesore dhe shume pozicione te tjera, jane ne cmim te tregut andaj si mund te permbushet dhe te realizohet kontrata nga ky OE ku cmimet e tij jane manipulative dhe spekulative

E njejta vlen edhe per OE Toni Engineering i cili poashtu ne paramasen e tij ka prezentuar cmime manipulative dhe nominalisht te uleta duke prezentuar keshtu nje oferte dyshyes dhe te papranueshme pasi cmimet e ofruara nuk jane cmime te tregut

Poashtu edhe Labinot Krasniqi BI ka ofruar cmime te njejta sikur OE e tjere te papergjshem, duke shfaqur cmime nen treg per shumicen e pozicioneve, andaj keto cmime te cilat jane ne cmim te tregut jane te papranueshme pasi cenojne AK-per moskryerjen e puneve si duhet Ky OE ka ofruar cmime nominalisht te uleta per shumicen e poziconeve: Te gjitha kabllo te cilat jane me fraksione te ndryshme i ka ofruar me cmime nen kosto ku sigurisht perpos furnizimit(ku keto cmime jane nen cmimin e blerjes) ketu duhet te behet edh emontimi i tyre, andaj cmimet e tilla jane te papranueshme Pozicioni 48 ku perpos germimit te dheut parashihet: Gërmimi i dheut dhe largimi i materialit, betonimi i themelit te shtyllave metalike me klasë te betonit C25/30. Dimensionet e themelit jane 80x80cmx80cm, komplet me gypin ø250mm l=0.8m, per mbjelljen e shtyllës, pra ne kete pozicion perfshihet me shume se nje sherbim dhe me shume se nje produkt andaj cmimi i ofruar eshte nominalisht i ulet, poashtu pozicioni i kuadrit shperndares i cili eshte me dimensione 600x600x20mm me te gjitha elementet e duhura per te qene funzkisonal eshte ofruar me cmim nominalisht te ulet.

Bazuar në këto oferta te ofruara nga keto OE nga te gjithë, shihet se asnje OE në fjalë nuk ka ofruar asnjë informatë apo sqarim bindës se si Opertaore ekonomik mundet të ju përmbahet çmimeve të tilla. Vlen të përmendet edhe një element me rëndësi që AK nuk ka kërkuar fare sqarim për asnje nga OE ku siq shihet nga çmimet ne paramase që realisht janë cmime jo normalisht të ulëta. Ne këtu i potenciuam vetem disa nga pozicionet e preznetuar ne partamse nga OE-te sa për ilustrim sepse si të tilla jane pothuajse shumicën e çmimeve që i kane ofruar OE-.

Psh: Artikullin tek pozicioni 49 në tregun e Kosovës me çmim të shumicës e ke së paku 110.00€ dhe atë të zbrazët pa elemente përcjellëse që AK i ka kërkuar. Ky çmim nuk është arsyetuar nga asnje nga OE-te pasi sigurisht qe do te ishte i kontestuar sepse nuk ka mundesi ekonomike dhe teorike me u arsyetua.

AK duke vepruar në kundërshtim me nenin 61 të LPP-së dhe nenin 41 të Rregullores për Prokurim Publik e ka rekomanduar për shpërblim me kontratë një OE i cili në tërësinë e paralogarisë së tij përbën një tender jo të besueshëm - jo-normalisht të ulët për faktin se nëse krahasohet me objektin e kontratës ka dallime substanciale në raport me çmimet reale të tregut. Kësisoj dhënia e kontratës një tenderuesi me çmime jo-normalisht të ulët ka ndikim negativ në performancë të implementimit të kontratës, rrjedhimisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës.

Duke qenë të bindur se ne si OE pjesëmarrës jemi dëmtuar nga rezultati i këtij aktiviteti me PASI QE përzgjedhja e OE të rekomanduar me kontratë është bërë në kundërshtim me kërkesat ligjore që dalin nga neni 59.4, neni 60 par.1.1 dhe neni 61 i LPP-së lidhur me nenin 41 të Rregullores për Prokurim Publik. Pas analizimit të hollësishëm të dokumentacionit të siguruar në dosjen e tenderit të OE të rekomanduar për shpërblim me kontratë dhe OE-ve te tjere duke analizuar edhe çmimet dhe kushtet e tregut kemi vërejtur se ofertat financiare (paralogaria) në shumicën e elementeve/pozicioneve të paramasës është me çmime të cilat në mënyrë substanciale janë nën nivelin e çmimeve reale të tregut andaj në pikpamje faktike fillimisht përbën tender jo të besueshëm dhe me çmime manipulative i cili ka për qëllim të shtrembërojë konkurrencën e drejtë të OE ankues,ku oferta jone është në pajtueshmëri me çmimet dhe kushtet e tregut dhe konkurrencës.

Ndërsa në pikëpamje juridike bazuar në kërkesat ligjore nga neni 61 i LPP-së dhe nenit 41 të Rregullores për Prokurim Publik, i njejti përbën tender me çmime jo-normalisht të ulët dhe njëkohësisht rrezikon cilësinë dhe ekzekutimin e kontratës. Andaj si i tillë në kuptim faktik e juridik ky tender do të duhej që të refuzohej si tender jo-normalisht i ulët, rrjedhimisht tender i papërgjegjshëm.

Në bazë të të gjitha fakteve dhe provave të paraqitura, rezulton se tenderet e dorëzuar nga OE-te përbëjnë tender jo-normalisht të ulët për faktin se është krijuar mbi bazën e çmimeve manipuluese, të ulëta me dallim disa herë nën nivelin e çmimeve reale të tregut dhe burimeve të besueshme siç janë çmimet e publikuara nga Zyra Statistikave të Kosovës dhe / ose çmime tjera indikative zyrtare (të tilla si zyra tatimore, zyra e doganave, oda ekonomike).

Konstatojmë se AK nuk e ka trajtuar tenderin në fjalë nga asnje OE , ashtu si duhet dhe për pasojë ka ardhur deri tek shpallja fitues e një tenderuesi me çmime spekuluese dhe mashtruese pasi në listën e tij të çmimeve dhe te OE-ve ka çmime që janë shumë të ulëta dhe ka çmime që janë shumë të larta në krahasim me tregun, gje qe të i kushtonte 4-5 herë më shtrenjtë AK-se dhe se ka edhe rrezik që një pjesë e konsiderueshme e artikujve të mos liferohen fare.

Ne nuk e pranojme vleresimin nga AK-ja, dhe vendimin e dhene per kontraten.

Ne ushtrojmë këtë kerkese PER RISHQYRTIM pranë AK-se, dhe:

Andaj , në pajtim me LPP-në dhe kriteret e FTD-së, sipas kritereve ne jemi me çmimin më të ulët dhe jemi OE i pergjeshem, kërkojmë që të rivlerësoni ofertën tonë dhe të shpallemi të përgjeshëm për këtë projekt.

Ne kërkojmë që lënda të kthehet në rivlerësim dhe Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve të bëhet konform dispozitave te nenit 59 te LPP-se sepse ne te kunderten do te bie ndesh me fushëveprimin e LPP.

AK duhet te anulroje vendimin e dhene dhe të aprovoj kërkesën tone për rishqyrtim.

Në bazë të sqarimeve dhe fakteve të prezantuara më lartë kërkojmë nga AK që ta aprovojë kerkesen tone duke marre parasysh përshkrimin dhe faktet e lartpërmendura, shkresave të lëndës, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës, dhe provat qe ju kemi ngarkuar dhe lëndën ta kthej në rivlerësim pasi që ne jemi kompania që i plotësojmë të gjitha kërkesat e kërkuara nga AK.

Ne kemi plotesuar te gjitha pikat sipas FTD ,andaj edhe kerkojme te rishqyrtohet edhe njehere ky vendim, andaj bazuar në faktet e lartëcekura më lartë kërkojmë që të nxjerrni:

V E N D I M

- I. APROVOHET** si e bazuar kerkesa e **OE. PLUS TRADE LLC, dhe lenda te kthehet ne**
- II. RIVLERESIM** gjate rivleresimit te shperblehemi ne me kontrate pasi qe i plotesojme te gjitha kriteret e Dosjes se Tenderit dhe te Njoftimit per Kontrate, pasi qe jemi OE i pergjegjshem me cmim me te lire, i plotesojme kriteret e kerkuara te FDT-se dhe te Njoftimit per kontrate/ Dosje te Tenderit, dhe ne si OE duhet te
- III. SHPERBLEHEMI** me kontrate per kete aktivitet pasi qe jemi OE i pergjegjshem me cmim me te lire.

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Plus Trade LLC, është dëmtuar financiarisht duke u nisur nga procedurat për përgaditje të ofertës, angazhimimin e stafit profesional(pagesat e bera) , sigurimin e ofertës, dhe duke humbur një projekt pa të drejtë duke dëmtuar financiarisht me fitimet që kemi pritur nga projekti.

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.